



N. Prot. 278

Tiranë, 22/7/2024

**Kriteret dhe Procedurat e pranimit për Shtetasit Shqiptarë në Programin e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë
Raundi i dytë, viti akademik 2024-2025**

Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ofron Programe Studimi Bachelor në Fizioterapi dhe Infermieristikë, Program të integruar Studimi Master në Mjekësi dhe Kirurgji dhe Program të integruar Studimi Master në Odontoiatri dhe Protezë Dentare në gjuhën italiane.

Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ofron Program të integruar Studimi Master në Mjekësi dhe Kirurgji (Medicine and Surgery) në gjuhën angleze.

Kuotat dhe kriteret e pranimit

Në vitin akademik 2024-2025, në raundin e dytë janë, kuotat e disponueshme për kandidatët shqiptarë janë:

Programe Studimi	Kuota të disponueshme
Program i integruar Studimi Master në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	15
Program i integruar Studimi Master në <i>Odontoiatri dhe Protezë Dentare</i>	
Program Studimi Bachelor në <i>Fizioterapi</i>	
Program Studimi Bachelor në <i>Infermieristikë</i>	

Për Programet e Studimit në Mjekësi dhe Kirurgji, Odontoiatri dhe Protezë Dentare, Fizioterapi dhe Infermieristikë, orari i konkursit, si dhe kuotat e disponueshme do të komunikohen pas çdo disponueshmërie të mundshme kuotash.

Kandidatët duhet të kenë përfunduar shkollën e mesme dhe të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të kenë një Diplomë të Arsimit të Mesëm;
- të plotësojnë kushtin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave n.436, datë 03/06/2020, i modifikuar me VKM n.46, datë 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës nota mesatare e shkollës së mesme për tu pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, në vitin akademik 2024-2025, **duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 6,5** (referuar sistemit arsimor shqiptar);
- të mos jenë të regjistruar njëkohësisht në programe të tjera studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private, shqiptare dhe/ose të huaja.

Përzgjedhja e kandidatëve për Mjekësinë dhe Kirurgjinë në gjuhën italiane do të bëhet nëpërmjet testeve të pranimit të cilat konsistojnë në:

1. Testim me shkrim në italisht, në formën e pyetjeve, për të vlerësuar njohuritë e kandidatëve në Shkencat (Biologji, Fizikë, Kimi dhe Matematikë)	30 pikë
2. Testim me shkrim për njohjen e Gjuhës Italiane.	20 pikë
3. Vlerësim i Notës Mesatare të Shkollës së Mesme.	30
Total	80 pikë



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Testimet e pranimit do të zhvillohen në selinë e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Rrugën “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri, në data e mëposhtme:

Programe Studimi	Data	Ora
Program i integruar Studimi Master në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	24.09.2024	10:00
Program i integruar Studimi Master në <i>Odontoiatri dhe Protezë Dentare</i>	24.09.2024	12:00
Program Studimi Bachelor në <i>Fizioterapi</i>	24.09.2024	16:00
Program Studimi Bachelor në <i>Infermieristikë</i>	24.09.2024	16:00

Edhe kandidatët që aspirojnë të vazhdojnë studimet pranë **selisë së Elbasanit** do t'i nënshtrohen edhe testit të pranimit më datë **24.09.2024 ora 16.00** në selinë qendrore të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri.

Për Programet e studimit Odontoiatri dhe Protezë Dentare, Fizioterapi dhe Infermieristikë, kuotat e disponueshme do të komunikohen pas disponueshmërisë së mundshme në përfundim të raundit të parë.

Pjesëmarrësit në testimin e pranimit duhet të paraqiten me një dokument identifikimi (kartë identiteti/pasaportë) pranë Sekretarisë Mësimore të paktën 30 minuta para fillimit të testit përkatës. Ndalohet futja dhe mbajtja gjatë testimit e mjeteve të komunikimit elektronik (celular, iPhone, iPad, etj.). Pjesëmarrësit që do t'i posedojnë do të përjashtohen menjëherë nga procedura e konkurrimit.

Renditja do të bëhet në bazë të rezultateve përfundimtare individuale, duke ndjekur rendin zbritës të pikëve të marra dhe do të publikohet në mjediset universitare dhe në faqen zyrtare www.unizkm.al më datë **25 shtator 2024**. Kandidatët mund të përjashtohen nga renditja nëse konstatohen parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim në testet e pranimit.

Kandidatët shqiptarë që aplikojnë për pranim në portalin U-Albania

I. Kryerja e aplikimit për pranim

Për të aplikuar për pranim në raundin e dytë, duhet të zgjidhni në portalin online U-Albania (<https://ualbania.rsimi.gov.al/>), Programet e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, në **periudhën 19 shtator - 21 shtator 2024**.

Për të marrë pjesë në testim, kandidatët duhet të paraqiten brenda datës **22-23 shtator 2024, brenda orës 16.30:**

- Pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit për të paguar tarifën e pjesëmarrjes në testin e pranimit prej 2 000 lekë. Kandidatët duhet të jenë të pajisur me një kartë identiteti/pasaportë dhe formularin e aplikimit të printuar nga portali U-albania.
- Pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë ¹ me të dhënat e mëposhtme:

Përfutyesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)

¹ Ju lutemi specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin(et) për të cilin po kryeni pagesën. Në ditën e testimit duhet të paraqitet një kopje e urdhërpagesës pasi koha e akreditimit është e kufizuar.



IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.

- Ose me kartë krediti online në portalin e Universitetit: <https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>

II. Regjistrimi/ Matrikullimi

Kandidatët shqiptarë të shpallur fitues të testit të pranimit të raundit të dytë duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore në periudhën **28 shtator - 7 tetor 2024**, sipas procedurave të përcaktuara në shpalljen N.265 dhe 266 dt. 22 korrik 2024 Siç parashikohet nga Dekreti Ministror n. 12 i datës 30.06.2024, i përditësuar, dhe Urdhrit të Përbashkët QSHA-RASH n.112 datë 05.07.2024, i përditësuar, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, kjo periudhë është e ndarë në 5 faza nga 48 orë (28-29, 30-01, 02-03, 04-05, 06-07). Këto faza vazhdojnë derisa të plotësohen vendet e disponueshme dhe përfundojnë më datë **07 tetor 2024**.

Për arsye të regjistrimit, kandidatët fitues të testeve të pranimit duhet të dorëzojnë në Sekretarinë Mësimore, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me një autorizim, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Faturën e pagesës bankare të kështit të parë ose të gjithë tarifës vjetore² (fletëpagesa mund të shkarkohet nga portali studentor: portal.unizkm.al, zëri: “Tarifat”);
- Diplomën e Shkollës së Mesme, kopje të noterizuar / Kopje të noterizuar të dokumentit të Njehsimit të Diplomës së Shkollës së Mesme të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë, bashkë me Certifikatën e notave të Shkollës së Mesme të noterizuar;
- Certifikatë Ndërkombëtare të Njohjes së Gjuhës në përputhje me Ligjin n.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” dhe në përputhje me Dekretet Ministrorë në fuqi (nëse kandidati ka detyrimin ta dorëzojë)
- Dy foto
- Certifikatë Mjekësore e Aftësisë për të studiuar;
- Certifikatë Vendbanimi;
- Certifikatë Familjare;
- Kopje e një dokumenti identifikimi të vlefshëm (kartë identiteti ose pasaportë);
- Dy foto.

Duhet gjithashtu të plotësojnë pranë Sekretarisë Mësimore:

- Aplikimin për Regjistrim (gjithashtu mund të shkarkohet nga Portali Studentor: portal.unizkm.al);
- Deklaratat e formuluar sipas Shtojcave nr. 1 dhe nr. 2 të V.K.M. nr.12 dt.30.06.2023
- Kontratën e regjistrimit;

² Në rast se kandidati plotëson kriteret e përcaktuara në rregulloren e Tarifave të Studimit për të përfituar kontributin e studimit, shuma që duhet paguar do të reduktohet në raport me tarifën e mbetur.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Heqja dorë nga studimet

Kandidati ka të drejtë të paraqesë kërkesë për të hequr dorë nga studimet në Sekretarinë Mësimore dhe të tërheq dokumentet e paraqitura gjatë regjistrimit në datat **8 - 9 tetor 2024**. Nëse kërkesa nuk bëhet në këto data, kandidati nuk do të ketë më të drejtë të ndryshojë programin e studimit për vitin aktual akademik. Kërkesa për të hequr dorë nga studimet bëhet në portalin U-Albania dhe në Sekretarinë Mësimore.

Rektori

Prof. Leonardo Palombi

